

# PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS:

## FUNKSIONIMI I "SPITALI AMERIKAN III"

**Vendodhja :** Rruga Sabaudin Gabrani,  
prane Fabrikes se Birres, Njesia  
Bashkiake nr 6, Tirane.

**Kërkues: Subjekti: " AMERICAN  
HOSPITAL" SH.A**

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

**"ENVIRONMENTAL MANAGERMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k**

Administrator

**Elidiana Shehu**



**Altin Ahmeti**

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014 )

**Ing. Elidiana Shehu**

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Shkurt, 2017

## 1. TE PERGJITHSHME, PERSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

### 1.1. Hyrje

Ky raport ka për qëllim të informojë institucionet e mbrojtjes së mjedisit dhe personat ose organizatat e interesuara për cilësinë mjedisore në lidhje me menyren e funksionimit të aktivitetit të qendres spitalore “American Hospital III”, i ndodhur në Rr. “Sabaudin Gabrani”, pranë fabrikës së Birres, Tiranë, si dhe masat e marra nga subjekti për reduktimin e ndotjes.



### 1.2. Informacion i shkurtër mbi shoqerine

Subjekti investitor i këtij aktiviteti është “Amerikan Hospital” Sh.A me NIPT” K61821002C. Ky subjekt është themeluar në datë 17.02.2006 dhe aktualisht ka si përfaqësues ligjor Z. Klodian Allajbeu. Objekti i veprimtarisë së këtij subjekti sipas përcaktimit në Ekstraktin e Qendres Kombëtare të Regjistrimit është:

Investime dhe shërbime në fushën e mjeksisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, importimi dhe eksportimi i materialeve të ndryshme. Industria e ndërtimit, shit-blerje, dhënie ose marrje me qera. Riparim i pajisjeve dhe punëve obliguese në montim. Përgatitje projektesh. Konsulencë teknike në fushën e ndërtimit dhe fusha të tjera., projektimi i pyjeve, etj.



### 1.3. Projekti i Propozuar

Objekti i projektit te propozuar eshte funksionimi i Spitalit American Hospital III, i ndodhur ne rrugen “Sabaudin Gabrani”, prane fabrikes se Birres, Tirane.

#### *Ortofoto e Spitalit Amerikan I*



*Ne tabelë paraqiten koordinatat e vendodhjes se Spitalit “American Hospital III”*

Pikat	X	Y
1	4398353.08	4576966.89
2	4398385.19	4576982.10
3	4398334.43	4577094.48
4	4398300.10	4577081.31

#### **1.4. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e mjedisit ku do të përfshihen kushtet fizike, të burimeve ujore, biologjike, atmosferike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese të përfituara rishtas mbi kushtet e mjedisit të sheshit që do të shfrytëzohet, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

#### **1.5. Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuara në procesin e VNM përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, cilesinë e ajrit, tokës, mjedisit biologjik dhe situatën social-ekonomike dhe kulturore. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të shfrytëzimit të burimit, rehabilitimit dhe monitorimit.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të kërkuar.

Metodologjia e hartimit të këtij raporti të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Vendimit të KM Nr. 13, datë 04.01.2013 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Metoda e përgatitjes së VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-se u bazua në:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Shqipëri për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit;
- Vlerësimin e përputhshmerisë së parimeve baze të rregullave shqiptare duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t'i zgjidhur ato;
- Përgatitjen e udhëzimeve për identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë përgatitjen e kriterëve seleksionues socialë dhe mjedisorë për të përzgjedhur projektet për implementimin dhe për të përcaktuar nivelin e studimeve/vlerësimeve sociale dhe mjedisore që kërkohen;
- Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese të nenprojektit në lidhje me zonën ku po ekzekutohet ky i fundit.

Institucionet pergjegjese kane ne organiken e tyre nje sere inspektorësh dhe teknike si ne nivelin qendror ashtu dhe ne ate rajonal, si dhe nje specialist te mjedisit, qe do te jete pergjegjes per monitorimin e ketij studimi dhe te vleresimeve te tjera mjedisore specifike si dhe do te trajtojne njesite e qeverisjes vendore per t'iu permbajtur kerkesave te parashtruara ne Leje Mjedisore

## **2. MBI LEGJISLACIONIN MJEDISOR DHE PERPTHJET E TIJ ME ATE NDERKOMBETAR**

### **2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezëve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyesme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, paisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

## **2.2. Kuadri ligjor kombetar**

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

**Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt klasifikohet ne listen e aktiviteve qe duhet te paisen me leje mjedisore te tipit B per te gjitha instalimet.**

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM paraprake. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

## **2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor**

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”**
  - **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”**
  - **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”**
  - **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar**
  - **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
  - **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
  - **Ligj nr. 37/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë”, të ndryshuar**
  - **Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”**
  - **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
  - **Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008**
  - **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”**
  - **Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin”.**
  - **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”**
  - **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”**
  - **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”**
  - **Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”**
  - **Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”**
  - **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”**
  - **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
  - **Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per Miratimin e rregullave pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se VNM-se...”**
  - **Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.**
  - **Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”**
- Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:
- **Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventes se Aarhusit”** Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimmarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.
  - **Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos”** ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).
  - **Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor”.**

- **Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit për protokollin e Montrealit” Për substancat që hollojnë shtresën e Ozonit.**
- **Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotesve”**

#### **2.4. Metodologjia e Vlerësimit**

Për hartimin e raportit të VNM, porositeshi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik, inxhinierik dhe juridik. Ky projekt përgatitet me kërkesë të investitorit, subjekti “AMERICAN HOSPITAL” Sh.A, si dhe janë kryer inspektime në terren për identifikimin e elementeve mjedisore dhe të biodiversitetit.

AKM dhe DRM, janë autoriteti kompetent ligjor për të kërkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin VNM, ku projekti në vlerësim do të nënshtrohet procedurave të raportit të VNM-se:

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit për procedurat shqiptare të VNM-se

<b>Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar</b>	<b>Procedura që Duhet Ndjekur (Duke plotësuar Standartet Shqiptare)</b>
Aneksi i Ligjit 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”	Sipas kërkesave të ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 për Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet për paisje me leje mjedisore të tipit B.



### **3. PËRSHKRIMI I FUNKSIONIMIT TE AKTIVITETIT**

#### **3.1. Te pergjithshme**

Objekti i projektit te propozuar eshte funksionimi i Spitalit "American Hospital III", i ndodhur ne rrugen "Sabaudin Gabrani", prane Fabrikes se Birres, Tirane.

#### **Kapaciteti i Projektuar**

Spitali Amerikan ka gjithesej 125 (njqind e njezet e pese ) shtreter te ndara me kate

#### **3.2. Pershkrimi i funksionimit te aktivitetit**

Kriteret e Ndertimit

1. Spitali furnizohet me Energji Elektrike nga rrjeti prej 20KV nepermjet 3(tre) transformatoreve me fuqi rreth 900 KVA secili, te cilet punojne ne menyre to pavarur. Ne rastet e nderprerjes se energjise elektrike i gjithe rrjeti shperndares furnizohet nepermjet gjeneratoreve me fuqi 900KVA secili, te cilet futen dhe dalin nga puna ne menyre automatike dhe to sinkronizuar ne lidhje me ngarkesen. Mos nderprerja me energji elektrike e pajisjeve spitalore dhe e ambjenteve te vecanta sigurohet nepermjet 3 UPS nga 200KVA secili. Panelet elektrike jane te pajisur me salvavite dhe automat sipas fuqive to pecaktuara
2. Spitali furnizohet me uje i cili sigurohet nepermjet linjes se ujesjellesit, pa nderprerje, futet ne depo nepermjet se cites sigurohet nje rezerve ujore prej 160m.kub sasi kjo e mjaftueshme per te perballuar situata emergjente te nderprerjes se ujit. Prej ketu pasi filtrohet, pompohet ne objekt nepermjet nje sistemi pompash treshe
3. Po ne keto depo jane instaluar dhe pompat qe sherbejne per hidrantet e shuarjes se zjarrit te cilat jane to vendosura ne te gjitha ambjentet e spitalit , si brenda dhe jashte tij. Se bashku me hidrantet jane vendosur dhe bombula per fikjen e zjarrit dhe keto te shperndara ne te gjitha objektin. Gjithashtu eshte instaluar dhe sistemi i sinjalizimit te zjarrit.
4. Per klimatizimin e ambjenteve spitalore jane instaluar dy chillera me kapacitete te mjaftueshme per stinen e ngrohte dhe dy kaldaja per stinen e ftohte . Ajri futet ne objekt pasi trajtohet ne AHU te cilat jane te pajisura me filtra antibakterial dhe hepafiltra te klasit H13.

Plotesimi I kriterëve per ndertimin e godines se spitalit American

- Te gjitha dhomat ne Spitalin Amerikan III jane dhoma me nje shtrat me nje siperfaqe prej 36 m2 (tridhjetë e gjashtë metra katror)
- Ne njesite e Terapise Intesive (Reanimacion) siperfaqja eshte prej 310 m2 (treqind e dhjetë metra katror)
- Per cdo shtrat ne dhomat e pacienteve kane paisje qendrore oksigjeni dhe vakumi td vecanta.
- Vendqendrimi i Infermierise eshte prane dhomave to pacienteve, e cila eshte e pajisur me lavaman, vend mjekimi dhe me system lidhes/thirres me dhomat e pacienteve.

- Saila Operacioni jane 5 (pese) te cilat perbehen nga 1(nje) shtrat me nje siperfaqe prej 35 m2.
- Ne hapsiren e miles se Operacionit lartesia dysheme tavan eshte 3.2 m (tre pike dy metra. Pjesa e korridorit qe ndodhet ne Bllokun Operator ka nje gjeresi te pakten 220 cm (dymetra e njezete centimetre)
- Sallat e Operacionit ajrosen me Kondicionimi- chiller me sistem qendror
- Spitali Amerikan ka gjithesej 125 (njqind e njezet e pese ) shtreter to ndara me kate si meposhte:
  - a) Kati 0 —aksesi ne kete kate eshte nga hyrja kryesore, ne te cilen ndoshet, laboraori, radiologjia (Skaner, Rezonance, Grafi, Skopi dhe Mamografi), Angiografi si dhe kardiologji.
  - b) Kati I — ne kete kate jane 23 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
  - c) Reanimacion — jane vendosur 18 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
  - d) Kati 2 — ne kete kate jane vendosur 26 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
  - e) Kati 3 - jane vendosur 33 shtreter /dhoma pacientesh individuale. Gjithashtu ndodhet dhe pavjoni i IVF.
  - l) Kati 4 — ne kete kate jane vendosur 2 dhoma lindje me reanimacion per leonat si dhe 25 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
- Shkallet ndermjet kateve kand nje gjeresi jo me pak se 1.50 m duke ofruar hapsire te mjaftueshme per levizjen e lirshme te barres dhe pacientit.
- Korridoret kane nje hapsire deri ne 2.2 metra
- Godina eshte e pajisur me shkalle emergjente
- Dyshemete dhe veshjet e tyre jane to mirerregulluara te buta dhe jo absorbuese
- Muret dhe tavanet e dhomave dhe td korridoreve pastrohen lehtesisht dhe mirembahen
- Reanimacioni eshte I pajisur me lavamane dhe ambiente te pershtateshme ku personeli mjekesor ka nen mbikqyrje pacientin gj ate gjithe kohes se qendrimit ne Reanimacion.
- Reanimacioni nuk ka lidhje direkte me ambientet e vizitoreve te pacienteve.
- Urgjenca ka hyrje me vete nga ajo e hyrjes qendrore to Spitalit.
- Kulla B — eshte vendosur poliklinika e spitalit, kati 1 — okulisitk, kati 2- ortopedi, reumatologji dhe endokrinologji. Ne katin 3 ndodheht dermatologjia dhe estetika, ne katin e 4 eshte vendosur Hemodializa me 23 shtreter.
- Te gjitha katet e spitalit dhe te poliklinikes kane akses me ashensor dhe me shkalle te brendshme.

#### *Ndricimi ne Spitalin Amerikan III*

- Ndricim I pershtatshem per te gjitha ambientet
- Me nje ventilim to pershtatshem te ajrit te fresket per pacientet dhe personelin

#### *Mobiljet dhe paisjet*

- Jane krijuar dhe lubrifikuuar per te thjeshtesuar pastrimin e tyre
- Nuk jane te demtuara

#### *Tualet jane te ndara*

- Per pacientet e shtruar
- Per pacientet ambulatory
- Per personelin mjekesor
- Per personelin administrative

Spitali Amerikan III I ploteson te gjitha kriteret per ushtrimin e veprimtarise sipas rregullave dhe legjislacionit ne fuqi dhe perkatesisht:

Kriteret per personelin mjekesor dhe jo mjekesor ka kualifikimet e nevojshme sipas vendit te punes qe ushtrojne.

Spitali Amerikan ka arshiven per ruajtjen e dokumentacionit mjekesor dhe administrative sipas ligjit nr. 9154 viti 2013 per "Arshivat". Spitali Amerikan permbushh kerkesat per dokumentacionin klinik to miratuar nga Ministria e Shendetsise dhe siguron databazen elektronike.

Spitali disponon rregullore mbi aktivitetin spitalor, semundshmerine bazuar ne programin statistikor kombetar per shendetsine miratuar nga Instat, ligji nr. 9180 date 05.02.2004 ' Per statistikat zyrtare", Ligji nr. 7761 date 19.10.1993 "Mbi parandalimin dhe luftimin e semundjeve infective". Ligjin nr 9952, date 14.07.2008 "Per parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS", Ligji nr. 8528, date 23.09.1999 "Per nxitjen dhe mbrojtjen e ushqyerjes me gji".

#### **Kriteret per menaxhimin mjekesor:**

- Spitali garanton te drejtat e pacientit, informon per procedurat mjkesore diagnostikuese, kuruese per to proceduar me aprovim/miratimin e tij per tju nenshtruar procedurave.
- Spitali ofron sherbim 24/ore me personel mjekesor te kualifikuar per te gjitha sherbimet per te cilat kerkohe licensimi.
- Spitali ka nje farmaci qe ploteson kriteret dhe kushtet ndertimore dhe ato te ruajtjes se barnave sipas percaktimeve te bera nga ligji nr. 9323 date 25.11.2004, I ndryshuar per barnat dhe sherbimin farmaceutik.
- Spitali ka nje laborator klinik, biokimik, mikrobiologjik, bakterologjik, imunologjik te cilat jane ne perputhje me nevojat e Spitalit.
- Spitali disponon njesi qendrore sterilizimi.
- Per mbetjet Spitalore te prodhuara nga aktiviteti mjekesor zbatohet rregullorja nr.6 date 30.11.2007 per eleminimin e mbetjeve Spitalore midis American Hospital sh.a & Kompanise Euroteam shpk.
- Per rastet EXITUS disponon morg i cili perbehet nga nje dhome frigoriferike dhe ka marreveshje me Institutin e Mjekesise Ligj ore per kryerjen e autopsise.
- Per Transfuzionin e gjakut kemi marreveshje bashkepunimi me QTKGJ
- Per mbrojtjen nga Infeksionet kemi program per reduktimin e rrezikut.

#### ***Materialet e Perdorura***


Materialet e zgjedhura Jane te teknologjise se fundit, kryesisht xham veshje me alukobond dhe kjo e fundit e kombinuar me ngjyren e xhamit. Dy ngjyrat e grise se alukobondit do te kombinohet me ngjyren e argjendit qe kane dritaret.

Neper pavione dhe sallat e operacioneve ne dysHEME eshte perdorur poliuretane, material ky shume I pershtatshem per strukturat Spitalore.

#### **Pamje satelitore e zones**



*Fota nga Qendra Spitalore" American Hospital III"*







### 3.3. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij kompleksi spitalor është që të realizohet një strukturë e plotë mjekësore e aftë që të administrojë operacione kirurgjikale të një niveli të lartë, në të gjitha drejtimet.

### 3.4. Strukturat Funktionale

Logjika organizative e strukturës në kompleksin e saj kërkon të mbulojë optimalisht objektivat vazhduese.

1. Optimizimi i lëvizjeve vertikale dhe horizontale nëpërmjet përcaktimit të zonave të specializuara, rrugët e lëvizjes së mjekëve dhe të operatoreve të brendshëm, rrugët e

vizitoreve te jashtëm por dhe nga zonat e shtrimit dhe te ambulateve, lëvizjen e mallrave dhe te shërbimeve te ndryshme, korridoret e lëvizjet për te sëmurët e shtruar brenda strukturës te ambienteve te shërbimit spitalor.

2. Optimizimi i pozicionimit te makinerive dhe pajisjeve te trajtimit te ajrit, qe duhet t'iu përgjigjen kërkesave te legjislacionit shëndetësore ne fuqi, për menaxhimin e hapësirës ajrore te cilat janë ne zonat kirurgjikale dhe ato te trajtimit te pacienteve.

Shpërndarja e funksioneve ne brendësi te ndërtesës mund te sintetizohet ne nivelet e ndryshme. Objekti zhvillohet ne 1,2,3 dhe 4 nivele mbi toke, perkatesisht:

- Kati 0 — aksesimi ne kete kate eshte nga hyrja kryesore, ne te cilen ndoshet, laboratori, radiologjia (Skaner, Rezonance, Grafi, Skopi dhe Mamografi), Angiografi si dhe kardiologji.
- Kati I — ne kete kate jane 23 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
- Reanimacion — jane vendosur 18 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
- Kati 2 — ne kete kate jane vendosur 26 shtreter /dhoma pacientesh individuale.
- Kati 3 - jane vendosur 33 shtreter /dhoma pacientesh individuale. Gjithashtu ndodhet dhe pavjoni i IVF.
- Kati 4 — ne kete kate jane vendosur 2 dhoma lindje me reanimacion per leonat si dhe 25 shtreter /dhoma pacientesh individuale.

### **3.5. Informacion për shkarkimet në mjedis.**

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes funksionale te “Spitalit American Hospital III” do te jene kryesisht Mbetjet e ngurta te aktivitetit spitalor, te cilat depozitohen ne kosha te vecante te pajisur me etiketimin e pershtatshem te paralajmerimit te mbetjeve te rrezikshme. Keto konteniere jane te ofruara nga subjekti qe kryen grumbullimin dhe asgjesimin e tyre. Spitali Amerikan ka lidhur kontrate me subjekt te licensuar per trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve spitalore me subjektin “ECO-Riciklim” sh.p.k.

Mbetjet e ngurta urbane, nuk perzihen me ato spitalore. Ato grumbullohen ne konteniere te ndare dhe depozitohen ne kontenieret e pastrimit te zones, nga subjekti i pastrimit te mbetjeve urbane.

Nuk ka shkarkime te ujerave te ndotura. Ujerat jane ato sanitare dhe te pastrimit te ambjenteve te spitalit.

Ujerat e aktivitetit, grumbullohen ne nje kolektor kryesor, i cili sherbene dhe si vaske dekantimi dhe me pas bashkohen ne sistemin e shkarkimeve te zones.

Objekti eshte i pajisur me sistem kanalizimesh si ne terrenet e jashtem edhe ne sistemin e objektit. Ujerat e shiut nuk perzihen me ato sanitare. Nuk ka problem permytjeje, ujerat kane sistem kullimi te mire projektuar.

### 3.6. Cilësia e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e zbatimit të projektit

Per zonen e Tiranës janë publikuar disa të dhëna të monitorimit të cilësisë së mjedisit nga raporti vjetor i monitorimit të mjedisit të Ministrisë së Mjedisit. Nuk janë kryer matje të elementeve të mjedisit të zonës pranë sheshit të zhvillimit nga Ministria e Mjedisit, edhe pse kjo zonë vlerësohet si zonë problematike me përqendrim të lartë të elementeve ndotës të mjedisit, për shkak të ndërtimeve të shumta kohët e fundit.

Me poshtë po ju paraqesim rezultatet e monitorimit të ajrit dhe zhurmave për qytetin e Tiranës të monitoruara nga Ministria e Mjedisit

Metodologjia e monitorimit të ajrit në vendin tonë


Për realizimin e procesit të monitorimit janë zbatuar metodat standarte, sipas të cilave përcaktohen mesataret kohore të monitorimit të cilësisë së ajrit, bazuar në direktivën CAFÉ të BE për një ajër të pastër dhe kërkesave të EEA për raportimet

Situata e cilësisë së ajrit urban në vendin tonë

Vlerësimi i situatës nga pluhurat (PM10, PM2.5)

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshijnë një diapazon të gjërë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diametër 10 dhe 2.5 micrometër ose më të vogël dhe emetohet direkte në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub>, dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse, ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojë sëmundjet e zemrës dhe mushkrive, goditje në zëmër dhe aritmi. PM mund të demtojë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme

Vlerat mesatare vjetore të PM10



Në grafikun e mësipërm janë dhënë vlerat mesatare vjetore të PM10 në 7 stacione monitorimi. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkalim të vlerës kufi të BE prej 40 µg/m<sup>3</sup> në tre stacione monitorimi në stacionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë së Mjedisit dhe Elbasan. Të tre stacionet janë stacione me burim ndotës trafikun ku numri i makinave që qarkullojnë në rruget pranë stacioneve është shumë i lartë. Në stacionin e AKM në ndotjen e ajrit nga PM10 përveç shkarkimit të automjeteve ndikon



edhe pluhuri I rrugeve dhe ndertimet. Vlera me e larte ditore eshte monitoruar ne muajn Prill dhe eshte  $142.55 \mu\text{g}/\text{m}^3$  nga  $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$  qe eshte standarti ditor i BE.

Problematike mbetet numri i diteve qe tejkalojne standartin ditor te BE-se ( $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ) ne 4 stacione: ne stacionin e AKM nr I diteve te tejkaluara nga 35 dite te tejkaluara eshte 190%, ne stacionin e MM, numri I diteve te tejkaluara eshte 77%

Numri i diteve qe tejkalon standartin e BE ( $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ )

PM10 (ditore )	Numri i diteve te tejkaluuar	Numri i diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkalin	35
Shkoder	3	35
Elbasan	57	35
Vlore	2	35
Korce	63	35

Vlera mesatare e nivelit te zhurmave ne 15 pikat e monitorimit te qytetit te Tiranes diten dhe naten.


Pikat e monitorimit	LAeq/Diten	LAeq/Naten dB (A)
Përballe Stadiumit Dinamo	64.5	53.4
Skënderbeu	71.5	60.2
Kryqëzimi tek Selvia	72	57.3
Rruga e Elbasanit	74.3	60.5
Partizani i Panjohur	70	57.8
Kryqëzimi Drejtoria e Policisë	63.9	53.1
Tek Shkolla 11 Janari	65	53.9
Laparakë	72.5	61.8
Farmacia 10	70.4	63.3
Perballe Shkolles se Bashkuar	63	53.3
Stacioni i Trenit	65.6	52.8
Pallati i Kongreseve	66.4	51.9
Kryq. 21 Dhjetori	69.4	61.5
Kryq. Vasil Shanto	66.7	57.7
Ish Blloku (B. A. )	62.9	60.6
Standarti i BE	55	45

Vlerat mesatare te nivelit te zhurmave ne qytetin e Tiranes, per vitin 2014 paraqiten me te larta se standartet e BE-se dhe ligjit Shqipetar si per periudhen e dites ashtu edhe per ate te nates

Paraqitja tabelore e vlerave mesatare te dites. LAeq/diten, per 15 pika monitorimi ne qytetin e Tiranes, ne 5 vitet e fundit te monitoruar

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Përballë Stadiumit Dinamo	71		71.2	70.6	64.5
Skënderbeu	69	71.8	69.5	71.8	71.5
Kryqezimi tek Selvia	71		70.2	68.2	72
Rruga e Elbasanit	71	74.9	74.4	75.1	74.3
Partizani i Panjohur	69	70.4	68.4	71.4	70
Kryqezimi Drejtoria e Policisë	74		75	73.5	63.9
Tek Shkolla 11 Janari	73		71.8	75	65
Laparakë	72	74.4	71.6	72.9	72.5
Farmacia 10	73	71.4	67	72.3	70.4
Përballë Shkollës së Bashkuar	72	-	72.7	65.6	63
Stacioni i Trenit	70	72.2	71.9	66.5	65.6
Pallati i Kongreseve	68	65.3	65	69.2	66.4
Kryq. 21 Dhjetori	74	70.6	70.5	72.4	69.4
Kryq. Vasil Shanto	74	71.9	71.2	81.2	66.7
Ish Blloku (B. A.)	70	64.9	61.4	60.9	62.9
<b>Standarti i BE</b>					<b>55</b>

Vlerat mesatare ne 5 vitet e fundit te monitoruar te dites ( 6:00, 23:00) per 15 pikat ne qytetin e Tiranes.




Ne 15 pikat e monitorimit te qytetit te Tiranes, verejme se nivelet e zhurmave LAeq/diten per vitin 2014 jane me te ultra krahasuar me vitin 2011, por krahasuar me standartet e BE-se ato vazhdojne te jene te larta ne te gjitha pikat e monitorimit

Paraqitja tabelare e vlerave mesatare te nates, LAeq/Naten, per 15 pikat e monitorimit ne qytetin e Tiranes, ne 5 vitet e fundit te monitoruar.

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Përballë Stadiumit Dinamo	55		55.1	56.5	53.4
Skenderbeu	56	61.5	60.6	60.7	60.2
Kryqëzimi tek Selvia	57		56.6	55.7	57.3
Rruga e Elbasanit	61	64.7	65	64.6	60.5
Partizani i Panjohur	54	59.1	58.8	57.5	57.8
Kryqëzimi Drejtoria e Policisë	54		53.4	52.6	53.1
Tek Shkolla 11 Janari	58		60.3	59.5	53.9
Laprakë	57	63.6	63.1	63.2	61.8
Farmacia 10	60	58.1	63.2	62.7	63.3
Përballë Shkollës së Bashkuar	57	-	56.7	53.9	53.3
Stacioni i Trenit	55	61.4	60.6	55.6	52.8
Pallati i Kongreseve	55	56.9	54.7	51	51.9
Kryq. 21 Dhjetori	65	65.9	61.4	63.7	61.5
Kryq. Vasil Shanto	63	67.7	62.6	69.4	57.7
Ish Blloku (B. A. )	62	59.3	60.5	63.1	60.6
<b>Standarti i BE</b>					<b>45</b>

Vlerat mesatare ne 5 vitet e fundit te nates, (23:00, 6:00) per 15 pika ne qytetin e Tiranës.



#### 4. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

##### 4.1. Te pergjithshme per Qarkun e Tiranës

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.



**Popullsia:** Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km<sup>2</sup> ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 682 banorë km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM <sup>2</sup>
Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11	557,422	757,361	1110.03
		Petrelë	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë			
		Farkë	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë			
		Dajt	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth			
		Zall-Bastar	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesem, Bastar – Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i vogel, Selitë Mali			
		Bërzhitë	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Killojë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë			
		Krrabë	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë			
		Baldushk	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunji, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i sipërm			

	<b>Shëngjergj</b>	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Faqesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje			
	<b>Vaqarr</b>	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë			
	<b>Kashar</b>	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek			
	<b>Pezë</b>	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë			
	<b>Ndroq</b>	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebillesh, Mënik			
	<b>Zall-Herr</b>	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh			

Tirana do të jetë bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror, pas bashkisë së Durrësit.

Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësirë. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit.

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoaria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizimi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Njesite administrative që rrethojnë Tiranën; Dajti, Farka, Vaqarri apo Kashari kanë dalë përtej klasifikimit “qendër e banuar rurale” Plotësimi i nevojave të zonave të reja urbane me kanalizime dhe ujë të pijshëm kërkon investime të konsiderueshme dhe një strategji të qartë.

Njesia administrative e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës.

Mbrojtja e mjedisit dhe kufizimi i ndotjes nga gazrat e makinave konsiderohet një problem emergjent për Tiranën, në kushtet kur qyteti ka kostot më të larta të transportit me taksi apo ka hapësira shumë të pakta për qarkullimin me biçikleta.

Një mendësi e re në shpërndarjen e lejeve të ndërtimit konsiderohet emergjente për Tiranën, e cila vuan nga betonizimi dhe reduktimi drastik i hapësirave të gjelbra. Zgjerimi i qytetit drejt njesive

administrative përreth krijon mundësi për të shfryrë presionin për leje ndërtimi ndërtim përmes zhvillimit të hapësirave të reja urbane.

Hartimi i planeve urbanistike tërësore në përputhje me kuadrin ligjor aktual të konsultimit publik si dhe transparencja e planeve urbanistike mund të ndihmojë në mbrojtjen e qytetit nga ndërtimet abuzive me apo pa leje.

#### **4.2. Mjedisi Fizik**

Qyteti i Tiranës zë vend në një rrafshinë midis Lumit Lana dhe Lumit Tirana. Kjo rrafshinë bën pjesë në një rrafshinë më të madhe ku ndodhen Kruja dhe Lezha, ujërat e të cilave rrjedhin drejt veriperëndimit. Mbi rrafshinë ngrihet 1600 metra Mali i Dajtit, i cili dominon horizontin në perëndim të qytetit. Kodrat më të ulëta të Saukut, Kërrabës dhe Vaqarit, që ngrihen 300 metra, rrethojnë luginën, përkatësisht në perëndim, lindje dhe jug. Kodrat më të ulëta formojnë vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave ajrore detare deri në Tiranë.

Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzjerje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbytjeje për qytetin.

#### **4.3. Tendencat Demografike**

**Popullsia:** Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km<sup>2</sup>, ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 682 banorë km<sup>2</sup>.

#### **4.4. Ekologjia**

Rajoni i Tiranës ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rushi e shumë bimë të tjera dekorative.

Përveç shkarjes së tokës, shkatërrimi i pyjeve nuk do të thotë vetëm humbje pemësh, por edhe humbje e diversitetit si pasojë e humbjes së zonave të habitatit dhe të zonave ushqyese.

#### **4.5. Gjeologjia dhe hidrogeologjia**

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore.

Tirana shtrihet në një shtresë ujë-mbajtëse me përmbajtje poroze, që është pjesërisht arteziane. Uji i nëndheshëm gjendet kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoret si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë.

Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe.


Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

#### 4.6. Ekonomia

Tirana është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstileve dhe e përpunimit të qelqit. Si në të gjithë vendin ashtu edhe kryeqyteti i Shqipërisë ndodhet në një periudhë tranzicioni. Pas rrëzimit të diktaturës komuniste shumë vepra të dikurshme industriale kanë dalë pjesërisht jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë rregullisht. Por ndërkohë po merren masa të shpejta për rimëkëmbjen dhe vënjen sa më të shpejtë në punë të veprave ekzistuese dhe të reja. Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit

#### 4.7. Klima

Në Tiranë mbizotëron një klimë nëntropikale-mesdhetare me rreshje dimërore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 1 189 mm shi.



*Burimi BBC Weather Service*

#### **4.8. Sizmiciteti**

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Tirana si shume zona te tjera te vendit eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo  $M_{max}=5.5-6.0$  grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copave te suvash por per objektet e uleta nuk parashikohen shqetesime. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

#### **4.9. Gjeologjia dhe Dherat**

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Tirana si zone e jashtme ben pjese ne Ultesiren Paramalore, dhe ndodhet ne krahinen e ultesires perendimore , dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor.